

## BILANCI I PAGESAVE<sup>1</sup>

### Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat dytësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

### Kryesore:

Në tremujorin e tretë 2024:

- Suficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 350 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 1,495 milionë euro, me rritje në terma vjetorë;
- Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 411 milionë euro, në të njëjtin nivel një vit më parë;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 262 milionë euro;
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.7 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, *bilanci i përgjithshëm i pagesave* rezultoi pozitiv, në rritje të mjetëve të rezervës valutore, rreth 367 milionë euro.

*Llogaria korrente* u mbyll me balancë pozitive prej 350 milionë euro, lehtësisht e ngushtuar në terma vjetorë me rreth 5 milionë euro (ose 1%), në sfondin e zgjerimit të konsiderueshëm të suficitit tregtar në shërbime.

Shkëmbimet tregtare në shërbime vijuan në trend pozitiv, në zgjerim të suficitit tregtar, me rreth 14% në terma vjetorë, në nivelin 1.5 miliardë euro. Kjo ecuri reflekton zgjerimin e bilanceve pozitive në shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit, si dhe në shërbime të tjera biznesi. Ndërkohë, shërbimet për përpunim të inpleteve fizike të zotëruara nga të tjerët shënuan rënie të balancës së tyre pozitive. Këto zhvillime sëbashku me zgjerimin tkurrjen e balancës negative të të ardhurave parësore (nga investimi) dhe zgjerimit të balancës pozitive të të ardhurave dytësore diktuan ecurinë e bilancit korrent për këtë periudhë, duke kompensuar zgjerimin e deficitit tregtar në mallra (me rreth 21% në terma vjetorë).


*Llogaria kapitale* u mbyll me një fluks neto negativ prej 63 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 57%. Tranfertat kapitale në hyrje ranë me rreth 10%, ndërsa ato dalëse u zgjeruan me rreth 6%. Në masë të konsiderueshme, flukset hyrëse dhe dalëse nën këtë kategori kanë qenë të përqendruara në sektorin privat.

*Shkalla e ekspozimit*<sup>2</sup> të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 287 milionë euro kundrejt nivelit prej 314 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

*Llogaria kapitale dhe financiare* (pa përfshirë mjetet e rezervës) rezultoi në fluks neto dalës, prej rreth 97 milionë euro, kundrejt atij prej 117 milionë euro, në të njëjtën periudhë një vit më parë.

Në një total prej rreth 34 milionë euro (pa përfshirë mjetet e rezervës) flukset neto dalëse në llogarinë financiare, reflektojnë zgjerimin e pretendimeve të ekonomisë shqiptare në investime të tjera (+270 milionë euro) dhe investime portofoli (+118 milionë euro), ndërkohë që investimet direkte zgjeruan lehtësisht pozicionin neto në fluks hyrës prej rreth -354 milionë euro në tremujorin e tretë të 2024.

*Rezerva valutore*, në fund të shtatorit 2024, shënon 5,862 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.7 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime dhe rreth 492% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve). Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

- Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN "Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të". Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njëzive rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.
- Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financiar ky ekspozim.
- Alokimi i SDR është një mënyrë për të plotësuar rezervat valutore të vendeve anëtare të Fondit, duke e lejuar anëtarët të zvogëlojnë varësinë e tyre në borxhin e brendshëm ose të jashtëm për ndërtimin e rezervave. Shqipëria ka përfutur nga alokimi i SDR nga viti 2009.

## LLOGARIA KORRENTE

Gjatë tremujorit të tretë 2024, vëlimi i përgjithshëm i transaksioneve korrente u zgjerua me rreth 10% në terma vjetorë, në nivelin 6,934 milionë euro. *Llogaria korrente* u mbyll me balancë pozitive prej rreth 350 milionë euro, e ngushtuar me 5 milionë euro ose 1% në terma vjetorë.

Suficiti korrent është diktuar nga zgjerimi i konsiderueshëm i suficitit *tregtar në shërbime*, me rreth 14% në terma vjetorë, në nivelin 1.5 miliardë euro. Kjo ecuri reflekton zgjerimin e bilanceve pozitive në *shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit*, si dhe në *shërbime të tjera biznesi*. Ndërkohë, *shërbimet për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët* shënuan rënie të balancës së tyre pozitive. Këto zhvillime sëbashku me zgjerimin tkurrjen e balancës negative të të ardhurave parësore (nga investimi) dhe zgjerimit të balancës pozitive të të ardhurave dytësore diktuan ecurinë e bilancit korrent për këtë periudhë, duke kompensuar zgjerimin e deficitit tregtar në *mallra* (me rreth 21% në terma vjetorë).

*Deficiti tregtar në mallra* u thellua me rreth 248 milionë euro në terma vjetorë dhe reflekton kryesisht zgjerimin e importeve në grupmallrat “*makineri e pajisje mekanike dhe elektrike*” e “*metale bazë*”, sëbashku me rënien e eksporteve të *produkteve minerale – energji elektrike dhe lëndë djegëse*.

*Të ardhurat parësore (puna dhe kapitali)* rezultojnë në balancë negative prej rreth -21 milionë euro, kundrejt -52 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. *Të ardhurat nga investimi* (kthimit nga kapitali) e ngushtuan balancën negative me rreth 8 milionë euro, ndërkohë flukset neto hyrëse të të ardhurave nga puna janë rritur me +22 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 90% e shpenzimeve korrente<sup>4</sup> kanë shkuar për financimin e importit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, hyrjet valutore<sup>5</sup> janë siguruar kryesisht nga eksporti i shërbimeve (në masën 71%), si dhe nga eksporti i mallrave dhe transfertave të njëanshme drejt sektorit privat (sëbashku në rreth 22%).

*Suficiti korrent u diktua nga zgjerimi i konsiderueshëm i suficitit tregtar në shërbime*

	Të dhëna kumulative (4-mujore) për fundin e periudhës, në milionë euro							
	T3 2023			T3 2024			T3 2023	T3 2024
	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Bilanci
<b>Llogaria korrente</b>	495	10,028	10,523	471	11,457	11,928	354.7	349.9
<i>në përqindje ndaj PBB</i>	-2%	48%	51%	-2%	47%	49%		
<b>Mallra</b>	4,558	1,796	6,354	5,268	1,789	7,057	1,207	1,455
<b>Shërbime</b>	3,153	6,140	2,988	3,732	7,247	3,515	1,310	1,495
Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët	745	745	1	676	676	1	198	140
Transport	294	665	371	431	795	364	150	210
Udhëtime	1,689	3,863	2,174	2,144	4,814	2,670	885	1,029
Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni	82	178	96	113	223	110	17	30
Shërbime të tjera biznesi	357	490	133	467	598	131	84	109
Shërbime dhe mallra qeveritare	5	48	43	7	45	52	2	0
Shërbime të tjera	18	151	169	91	96	188	23	22
<b>Të ardhura parësore</b>	285	730	1,015	223	938	1,161	52	21
Të ardhura nga puna	506	541	35	604	643	39	158	180
Të ardhura nga investimet	792	179	972	827	286	1,113	210	202
Investime direkte	738	68	806	781	104	885	211	210
Investime portofoli	4	49	45	2	75	74	14	17
Investime të tjera	106	15	121	137	18	155	31	33
Mjetet e rezervës	48	48		89	89		19	25
Të ardhura të tjera parësore	1	9	9	0	10	9	0	0
<b>Të ardhura dytësore</b>	1,195	1,361	166	1,287	1,482	194	304	331
Të ardhura nga emigrantët	918	918	-	1,024	1,024	-	233	262

Tabela. Ecuria e përbërësve të bilancit të pagesave (*shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve*)

<sup>4</sup> Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat parësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.

<sup>5</sup> Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat parësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.



## TREGTIA E MALLRAVE


Vëllimi i përgjithshëm i tregtisë në mallra u zgjerua me 11% në terma vjetorë, në nivelin 2,271 milionë euro. Tregtia në mallra përfaqëson rreth 33% të transaksioneve korrente.

Eksporti i mallrave ra me 3% në terma vjetorë, në nivelin 408 milionë euro. Rënie e konsiderueshme është vërejtur në eksportet e “produkteve minerale”, ndërsa janë rritur eksportet e “metaleve bazë”.

Importi i mallrave u zgjerua me 14% në terma vjetorë në nivelin 1,863 milionë euro. Rritjen më të madhe e shënuan importet në grupmallrat “makineri e pajisje mekanike dhe elektrike” dhe “metale bazë”.

Deficiti tregtar në mallra shënon 1,455 milionë euro, i thelluar në terma vjetorë me 21%.

Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 21.9% nga 25.8% në një vit më parë.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

## TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve u mbyll me një balancë pozitive, prej rreth 1,5 miliardë euro, e zgjeruar në terma vjetorë me rreth 14%.

Vëllimi i transaksioneve tregtare në shërbime u rrit me rreth 9% në terma vjetorë. Kjo ecuri u diktua nga zgjerimi i vëllimit tregtar në shërbime udhëtimit dhe transporti, në reflektim të zgjerimit të kërkesës turistike në vend. Në të njëjtën kohë, shërbimet e biznesit zgjeruan balancën e tyre pozitive.

Shërbimet e udhëtimit kanë zgjeruar balancën pozitive në +1,029 milionë euro, kundrejt nivelit +885 milionë euro, në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në terma vjetorë, të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj kategorie u rritën respektivisht me rreth 15% dhe 13%. Rritja e numrit të udhëtarëve përbën faktorin përcaktues për këtë ecuri. Në të njëjtën kohë, shpenzimi ditor për udhëtar është vlerësuar në rritje, ndërsa sa i takon ditëqendrimin ky i fundit është ulatur rreth të njëjtit nivel në vitin e kaluar.

Për tremujorin e tretë 2024, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 1,9 miliardë euro. Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 879 milionë euro.

Shërbimet e udhëtimit gjenerojnë respektivisht 74% të flukseve valutore në hyrje dhe rreth 80% të shpenzimeve të kategorisë së shërbimeve.

*Thellimi i deficitit tregtar në mallra reflektoi zgjerimin e kërkesës së brendshme për importe në makineri e pajisje mekanike e elektrike, sëbashku me rënien të eksporteve në energji elektrike dhe lëndë djegëse*



Shërbimet e transportit kanë zgjeruar balancën pozitive me rreth 59 milionë euro, në sfondin e zgjerimit të transportit ndërkombëtar të pasagjerëve.

Shërbime të tjera biznesi rezultuan me bilanc pozitiv prej 109 milionë euro, në rritje vjetore prej 30%. Për tremujorin e tretë të vitit, flukset valutore hyrëse për ekonominë shqiptarë nën këtë kategori shërbimi, shënuan rreth 145 milionë euro.

Bilanci pozitiv i shërbimeve për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët<sup>6</sup> u vlerësua në 140 milionë euro nga 199 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo kategori shërbimesh regjistron vlerën e shtuar neto nga shërbimi, që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara (ose më lëndë të parë) prej këtyre të fundit.

## TË ARDHURAT PARËSORE


Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me balancë negative prej 21 milionë euro nga -52 milionë euro në të njëjtën periudhë një vit më parë. Flukset hyrëse dhe dalëse, të kësaj kategorie të ardhurash, u rritën respektivisht me 23% dhe 7% kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Të ardhurat neto faktoriale nga puna, të cilat kryesojnë flukset hyrëse të të ardhurave parësore, rezultuan në një fluks neto pozitiv prej 180 milionë euro ose 14% më shumë se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Rritja i dedikohet në masën më të madhe rritjes së numrit të punonjësve sezonalë dhe kufitarë jashtë vendit.

Të ardhurat neto nga investimet ngushtuan balancën negative, në nivelin 202 milionë euro nga -210 milionë euro në tremujorin e tretë të 2023. Investimet direkte mbizotërojnë si instrument, flukset valutore neto nga investimi. Këtë tremujor, fluksi dalës neto në formën e fitimit të riinvestuar<sup>7</sup> shënon 234 milionë euro nga 221 milionë euro në një vit më parë.

Ndërkohë, pagesat e interesave për huatë shënuan 38 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 7%.

Zgjerimi i të ardhurave nga puna ka përmirësuar balancën negative të të ardhurave parësore



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

<sup>6</sup> Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera nga industria e përpunimit me lëndë të parë të huaj në vend.

<sup>7</sup> Konform standardit metodologjik—parimit të regjistrimit të dyfishtë të transaksionit, zëri “fitim i riinvestuar”, si komponent i investimeve direkte në llogarinë financiare, duhet të regjistrohet edhe në llogarinë e të ardhurave parësore nga investimet. Ky regjistrim kryhet në masë të njëjtë, por në kahe të kundërta.




## TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 331 milionë euro. Rreth 79% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga "të ardhurat nga emigrantët".

Prurjet valutore të emigrantëve shënuan rreth 262 milionë euro, në rritje vjetore (13%).

Gjatë periudhës është vërejtur zgjerim jo vetëm në volumin e dërgesave përmes kanaleve formale (sistem bankar), por edhe prurjeve në cash.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

*Për tremujorin e tretë të vitit 2024, prurjet valutore nga emigrantët vlerësohen në rreth 262 milionë euro*

## LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto negativ prej 63 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 57%. Tranfertat kapitale në hyrje ranë me rreth 10%, ndërsa ato dalëse u zgjeruan me rreth 6%. Në masë të konsiderueshme, flukset hyrëse dhe dalëse nën këtë kategori kanë qenë të përqendruara në sektorin privat.

## LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) rezultoi në një fluks neto dalës prej rreth 34 milionë euro, krahasimisht me fluksin dalës prej 77 milionë euro, të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2023.


Flukset neto dalëse në llogarinë financiare reflektojnë zgjerimin e pretendimeve të ekonomisë shqiptare në investime të tjera (+270 milionë euro) dhe investime portofoli (+118 milionë euro), ndërkohë që investimet direkte zgjeruan lehtësisht pozicionin neto në fluks hyrës prej rreth -354 milionë euro në tremujorin e tretë të 2024.

Fluksi hyrës nga investimet e huaja direkte shënon 412 milionë euro, pa lëvizje të konsiderueshme (ose +0.1%) nga niveli i regjistruar në një vit më parë. Brenda kësaj kategorie, komponenti fitim i riinvestuar është zgjeruar me 15% në terma vjetorë dhe shënon 234 milionë euro, ndërkohë që injektimi në kapital u vlerësua 178 milionë euro, ose 17% më pak se një vit më parë. Më tej, marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura nën një marrëdhënie të investimit direkt, rezultuan me një fluks dalës prej 1 milionë euro (shlyerje të detyrimeve si instrument borxhi mes kompanive të lidhura) kundrejt fluksit dalës prej -6 milionë euro në të njëjtën periudhë një vit më parë.




Gjatë tremujorit të tretë 2024, flukset valutore hyrëse në formën e *investimeve të huaja direkte* ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme (në masën 20%), sektorin e ndërmjetësimit financiar (në masën 19%), e hidrokarbureve (në masën 14%), e energjitikës (në masën 11%), si dhe komunikacionit (në masën 4%).

Në të njëjtën kohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *investimeve direkte jashtë* vlerësohen në rreth 57 milionë euro, në rënie me rreth 7%.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe flukset neto sipas kategorive përbërëse (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)



Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër

*Investimet e portofolit* rezultuan në një fluks neto dalës prej 118 milionë euro. *Sektori i Korporatave Depozituese* ka zgjeruar zotërimet jashtë në letra me vlerë të borxhit, me rreth 109 milionë euro. Në të njëjtën kohë, ka vijuar rënia e detyrimeve ndaj jorezidentëve, në drejtim të tkurrjes së ekspozimit të *letrave me vlerë të borxhit* me 19 milionë euro (si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes së bankave rezidente në eurobondin e *Qeverisë së Përgjithshme*).

Llogaria *investimet e tjera* u mbyll në një fluks neto dalës prej 270 milionë euro, ku zhvillimet kryesore lidhen me sektorin e *Korporatave Depozituese* dhe të *Qeverisë së Përgjithshme*.


*Sektori i Korporatave Depozituese* ka zgjeruar pretendimet në “monedha e depozita” me jorezidentët, me rreth 241 milionë euro, si dhe në të njëjtën kohë ka rritur detyrimet afatshkurtra në *huamarrje* ndërbankare, me rreth 28 milionë euro.

*Qeveria e Përgjithshme* ka shlyer detyrimet në formën e *huasë*, me rreth 59 milionë euro.

*Sektorët e tjerë*, kanë ngushtuar pretendimet (në kahun e mjeteve) për “kredi tregtare dhe paradhënie” me rreth 19 milionë euro dhe në të njëjtën kohë, në kahun e detyrimeve rezutojnë në tkurrje të tyre ndaj jorezidentëve në formën e “kredi tregtare dhe paradhënie” prej rreth 42 milionë euro.

*Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 411 milionë euro, dhe ruajnë të njëjtin nivel të një viti më parë*





Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Gjatë tremujorit të tretë 2024, mjetet e rezervës u zgjeruan me 367 milionë euro, ndikuar kryesisht nga blerjet e valutës dhe rivlerësimi pozitiv i instrumenteve në përmbajtje të portofolit të rezervës valutore.

Në fund të periudhës, rezerva valutore shënon 5,862 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.7 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.

*Rezerva valutore  
vlerësohet mjaftueshëm  
për mbulimin e 6.7  
muaj importe mesatare  
vjetore në mallra e  
shërbime*



**DEPARTAMENTI I  
STATISTIKAVE  
FINANCIARE**

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së  
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,  
Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01  
+ 355 4 241 93 02  
+ 355 4 241 93 03  
+ 355 4 241 94 09  
+ 355 4 241 94 10  
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08  
Email: [statistics@bankofalbania.org](mailto:statistics@bankofalbania.org)



*Shënime:*

*Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihë përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.*

*Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave, si pasojë e rishikimeve, pasojë e plotësimit të informacionit me të dhëna nga njësitë raportuese.*

*Është rishikuar seria kohore T1/2024-T2/2024, bazuar në politikën e rishikimit të Bankës së Shqipërisë.*

*Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:*

[https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat\\_e\\_Sektorit\\_te\\_Jashtem/Bilanci\\_i\\_Pagesave/Te\\_dhenat\\_kryesore\\_per\\_Bilancin\\_e\\_Pagesave.html](https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html)